



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË  
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

**OPINION MBI KANDIDATIN Znj. VITJUNA MATA**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 12.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores Vitjuna Mata, e cila është e caktuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe prej një viti është e komanduar si Këshilltare pranë KLP dhe ka rishfaqur vullnetin për t’u komanduar përsëri në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurorja Vitjuna Mata ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2015, pasi me dekretin nr. 9220, datë 07.09.2015 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Nga dosja personale rezulton se nuk ka patur transferime dhe e ka ushtruar detyrën vetëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Znj. Mata ka një eksperiencë profesionale në punë si prokuror rreth 4 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, aktualisht është e komanduar prej 1 viti si Këshilltare pranë Këshillit dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr.1959 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë rezulton se për shkak ngarkese në këtë Prokurori, vetëm një prej tre kandidaturave të ardhura nga kjo Prokurori, nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë së Vlorës.

Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se në kushtet kur janë tre kandidatura nga e njëjta prokurori për vetëm një vend dhe nga ana e Drejtuesit nuk është dhënë një emër konkret, vlerësojmë se në rastin e znj. Vitjuna Mata nuk çenohet interesi më i lartë i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për shkak se ajo ka qenë më parë e komanduar në këtë pozicion dhe nuk ka në administrim dosje penale. Gjithashtu Komisioni vlerëson faktin e eksperiencës së saj të deritanishme në pozicionin e Këshilltares pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë,.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

*Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror Znj. Vitjuna Mata.*

## **KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

Datë: 24.02.2020